



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1833, datë 09.03.2012

Për

“Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Publik Telefonik të Qëndrueshëm dhe Kontrata Tip për Shërbimin Akses në Internet për sipërmarrësin Teeb Center sh.p.k”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 09.03.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm dhe Kontrata Tip për shërbimin e Akses në Internet për sipërmarrësin Teeb Center sh.p.k.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 5, neni 99 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);

2. Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (**Ligji nr. 9902**);
3. Neni 15, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
4. Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3, të nenit 138, të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa nr. 19 prot., datë 6.1.2012 e AKEP, drejtuar sipërmarrësit Teeb Center sh.p.k, “*Kërkesë për depozitim pranë AKEP për miratim të Kontratës Tip me Pajtimtarin*”;
- Shkresa nr. 86 prot, datë 20.1.2012 e sipërmarrësit Teeb Center sh.p.k depozituar në AKEP me nr. 19/5 prot, datë 23.1.2012, “*Ridërgojmë Kontrat tip të pajtimtarit për shërbimin e telefonisë së qendrueshme dhe të shërbimit Akses në Internet*”;
- Projektvendimin për “Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtarit (Kontratë Tip) për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm dhe Kontrata Tip për shërbimin e Akses në Internet për sipërmarrësin Teeb Center sh.p.k”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Teeb Center sh.p.k, me shkresën nr. 86 prot, datë 20.1.2012 depozituar në AKEP me nr. 19/5 prot, datë 23.1.2012, “*Ridërgojmë Kontrat tip të pajtimtarit për shërbimin e telefonisë së qendrueshme dhe të shërbimit Akses në Internet*”, kërkon miratimin e Kontratës të mësipër cituar bazuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008;
2. Teeb Center sh.p.k., në hartimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtarit (Kontratë Tip) për shërbimin publik të telefonisë së qëndrueshme dhe Kontrata Tip për shërbimin e Akses në Internet ka marrë në konsideratë dhe siguron mbrojtje të konsumatorit sipas përcaktimeve dhe parashikimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, të ligjit nr. 9902, dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie;
3. Për sa më sipër, AKEP konstaton se, Kontrata Tip e Telefonisë së Qëndrueshme, dhe e kontrata për shërbimin e Akses në Internet për pajtimtarin e Teeb Center sh.p.k është e drejtë dhe e bazuar;
4. Gjithashtu, AKEP me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të konsumatorit, bazuar në:

- i. Qëllimin e garantimit të shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në Shqipëri, të shprehur në nenin 1, të ligjit nr. 9918, dhe,
- ii. Objektivat rregullatore për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të shprehur në gërmat a) dhe b), pika 3, neni 7 i ligjit nr. 9918, çmon të arsyeshme miratimin e Kontratës Tip për shërbimin telefonik publik të qendrueshëm dhe Kontratën e shërbimit Akses në Internet për pajtimtarin sipas dokumentit bashkëlidhur.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për sipërmarrësin dhe për pajtimtarët,

V E N D O S:

1. Të miratojë Termat e Përgjithshme të Kontrates (Kontrata Tip) të sipërmarrësit Teeb Center sh.p.k me Pajtimtarin për Shërbimin Publik Telefonik të qendrueshëm, sipas dokumentit bashkëngjitur këtij Vendimi;
 2. Të miratojë Termat e Përgjithshme të Kontrates (Kontrata Tip) të sipërmarrësit Teeb Center sh.p.k me Pajtimtarin për Shërbimin Akses në Internet, sipas dokumentit bashkëngjitur këtij Vendimi;
 3. Teeb Center sh.p.k të zëvendësoje kontratat ekzistuese me kontratat e reja, brenda datës 9.5.2012;
 4. Teeb Center sh.p.k. të publikoje në faqen e tij të Internetit termat e përgjithshme të kontratave Tip, të miratuara me këtë Vendim;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

**TERMAT E PERGJITHSHSME TE KONTRATES (KONTRATA TIP) TE TEEB
CENTER SH.P.K ME PAJTIMTARIN PER SHERBIMIN PUBLIK TELEFONIK TE
QENDRUESHEM**

KONTRATA E PAJTIMTARIT PER SHERBIMIN PUBLIK

TELEFONIK TE QENDRUESHEM

NË RRJETIN E OPERATORIT TE TELEFONISE SE QENDRUESHME _____

NR. _____, DATË _____

KATEGORIA E PAJTIMTARIT:

NUMRI TELEFONIT

--	--	--	--	--	--	--	--

Lidhur në _____, më datë _____, ndërmjet

Emri i Operatorit: _____, Rajoni/Zona _____ Operator i Sherbimit te
Telefonise Publike Fikse qe me poshte do te quhet OPERATOR, me seli ne adresën :
_____ I perfaqesuar nga Z/Znj _____

Dhe

z.znj. _____, me zotësi të plotë juridike për të vepruar me adresë :
(emri, atesia, mbiemri)

Lagjia _____, Rruga _____, Pallati/Godina _____, Shkalla _____,
Ap. _____, me dokument identifikimi _____, Nr _____, që më poshtë
do të quhet **PAJTIMTAR.**

BAZA LIGJORE

Kjo Kontrate hartohet ne zbatim te :

1. Ligjit Nr. 9918 date 19.05.2002 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”;
2. Ligjit Nr. 9902 date 17.04.2008 “Per Mbrojtjen e Konsumatoreve”;
3. Ligjit Nr. 9887 date 10.03.2008 “Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale”;
4. Ligje dhe akte nenligjore qe rregullojne kete marredhenie ne Republiken e Shqiperisë.

KUSHTE TE KONTRATËS

Neni 1. OBJEKTI KONTRATËS

Përcaktimi i kushteve, detyrimeve dhe të drejtave të ndërsjellta, Operator-Pajtimtar, për shfrytëzimin e Shërbimeve te Komunikimeve Elektronike të ofruara nga Operatori nëpërmjet rrjetit të tij te Komunikimeve Elektronike.

Neni 2. TARIFAT DHE SHËRBIMET

1. Shërbimet dhe tarifate e tyre, te ofruara nga Operatori dhe te pranuar nga pajtimtari, paraqiten ne Aneksin e kesaj kontrate dhe jane pjese integrale e Kontrates se nenshkruar midis paleve.
2. Tarifate e Shërbimeve jane objekt ndryshimi , te cilat vendosen dhe publikohen sipas kërkesave te ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republiken e Shqipërisë”.

Neni 3. DETYRIMET

3.1 OPERATORI DETYROHET:

- 3.1.1 Të ofrojë shërbime publike të telefonise fikse , përfshirë shërbimet shtesë të zgjedhura ne Aneksin nr.1, brënda 3(tre) ditë pune, llogaritur nga data e lidhjes së kësaj kontrate.
- 3.1.2 T’i siguroje Pajtimtarit mundësinë e shfrytëzimit të shërbimeve publike të telefonise fikse dhe shërbime te telekomunikacioneve që ofrohen nga Operatori dhe sipërmarrësit e autorizuar per te ofruar rrjete dhe shërbime publike te komunikimev elektronike.

- 3.1.3 Te marre dhe te zbatoje masa teknike dhe organizative per te siguruar rrjetin, sherbimin, konfidencialitetin e komunikimit dhe te dhenat e trafikut te komunikimit sipas neneve 122,123 dhe 124 te ligjit nr. 9918.
- 3.1.4 Te siguroje mundesine e paraqitjes dhe te parandalimit te identifikimit te linjes se thirrur dhe asaj thirrese.
- 3.1.5 Të riparoje difektet në rrjetin e tij të telekomunikacioneve dhe të rivendosë ofrimin e shërbimeve:
- brënda 1(nje) dite kalendarike, llogaritur nga momenti i njoftimit në numrat e informacionit të Operatorit, për difekte të natyrës së zakonshme.
 - brënda 3 (tre) ditëve kalendarikë, llogaritur nga momenti i njoftimit në numrat e informacionit të Operatorit, për difekte të rënda.
- 3.1.6 Të njoftojë te pakten 48 ore me pare per ndërprerjen e plotë apo te pjesshme të shërbimeve, për kufizime të tyre, ne rast permiresimi, modernizimi, mirembajtjeje, probleme teknike ne rrjet apo kur këto vijnë nga dispozita të vecanta ligjore si dhe për ndërprerje që vijnë nga fatkeqësi natyrore, zbatime të emergjencës kombëtare ose lokale dhe jo me vone se 48 ore pas ndodhjes se kufizimit apo nderprerjes se shkaktuar nga defekte apo demtime te rrjetit.
- 3.1.7 Të evidentojë ankesat dhe shqetësimet e Pajtimtarit, dhe t'a informojë atë me shkrim për zgjidhjen e tyre brënda 15 (pesembdhjetë) ditëve kalendarike, llogaritur nga data e njoftimit në zyrat përkatëse të Operatorit.
- 3.1.8 Të evidentojë, ditën e fundit të periudhes se faturimit, kohezgjatjen e bisedave të kryera nga Pajtimtari.
- 3.1.9 Të sigurojë kushte për pranimin e pagesave nga Pajtimtarit, për gjatë gjithë ditëve të javës, me orar ____: ____ .
- 3.1.10 Të riaktivizojë sinjalin e Pajtimtarit, brënda 1(një) dite kalendarike, nga momenti kur Pajtimtari ka shlyer të gjithë detyrimet financiare të prapambetura.
- 3.1.11 Të sigurojë fshehtësinë e komunikimeve të Pajtimtarit, dhe kur kërkohet prej tij edhe, konfidencialitetin e të dhënave personale.
- 3.1.12 Të sigurojnë dërgimin pa pagesë të thirrjeve drejt numrave të emergjencës, edhe kur aksesit per sherbime telefonike eshte i kufizuar.
- 3.1.13 Të marrë në konsideratë mospublikimin e të dhënave personale ne numeratorin telefonik, kur një gjë e tillë kërkohet nga Pajtimtari.
- 3.1.14 Të njoftojë nëpërmjet medias, afishimeve pranë njësive arkëtimore dhe zyrave të tij, cdo ndryshim të çmimeve dhe tarifave të shërbimeve të ofruara prej tij, jo më vonë se 7 (shtate) ditë kalendarikë përpara zbatimit të tyre.
- 3.1.15 Të trajtojë dhe zgjidhë, brënda 3(tre) ditëve kalendarike, kërkesën e Pajtimtarit për cdo ndryshim të shërbimeve shtesë dhe të kategorisë së pajtimit.
- 3.1.16 Të instalojë Paisjen Fundore _____ në ambientet e Pajtimtarit brënda 3(tre) ditë pune, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës.

- 3.1.17 Te njoftoje me shkrim, per zbatimin e sanksioneve sipas pikes 7.2.c dhe te pikes 7.2.e , ne rast mospermbushje te detyrimeve kontraktore nga Pajtimtari.
- 3.1.18 Të trajtojë kërkesën me shkrim të Pajtimtarit për transferimin ose ndryshimin e numrit të telefonit dhe t'i ktheje përgjigje brenda 10(dhjetë) ditë pune.
- 3.1.19 T'i përgjigjet me shkrim brenda 7(shtatë) ditëve kalendarike kërkesës së Pajtimtarit për ndërprerjen e kontratës.
- 3.1.20 Të ofrojë shërbime publike te telefonise fikse, ne perputhje me treguesit e cilesise. Operatori eshte i detyrar t'i publikoje ne formen e duhur ne menyre qe te jene te krahasueshme dhe te perditesuara per sherbimet e ofruara.
- 3.1.21 Të zbatojë, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Pajtimtarin, procedura të thjeshta, duke bashkëpunuar për këtë qëllim me të gjitha institucionet perkatese per te mbrojtur te drejtat e konsumatoreve. Menyra dhe procedura per zgjidhjen e mosmarreshjeve, ankesave te pajtimtareve percahtohen në Udhëzuesin, pjesë e Kontratës se Pajtimtit.
- 3.1.22 Të njoftojë Pajtimtarin për modifikime të kesaj kontrate jo me vone se 30 dite perpara dates se hyrjes ne fuqi te ketyre modifikimeve.
- 3.1.23 Te pergatise, Kontraten dhe gjithë elementet e saj, ne format te printuar, lehtesisht te lexueshem dhe te kuptueshem.
- 3.1.24 Me kerkesen e Pajtimtarit, ben kontraten te disponueshme per Pajtimtarin ne format te pershtshem per te plotesuar nevojat e personave me aftesi te kufizuara shikimi.
- 3.1.25 T'i jape Pajtimtarit nje shpjegim te hollesishem te te gjitha kushteve te perdorimit dhe kontrates para nenshkrimit te kontrates.
- 3.1.26 T'i jape pajtimtarit informacion te detajuar per programet tarifore qe mund te zgjedhe pajtimtari, duke i dhene mundesine e krahasimit midis tyre, perfshire:
- i informacion te plote dhe te qarte, per paketat tarifore dhe ofertat promocionale apo speciale si zbritjet e tarifave, trafik i pakufizuar, kohen e kryerjes se thirrjeve, duke specifikuar midis te tjerave cfare perfshihet ne pakete/oferte dhe cfare nuk perfshihet ne to, afatet kohore te ofertave dhe efektet e tejkallimit te tyre, perfshire tarifate e aplikuar.
 - ii Sistemin tarifor te aplikuar per sherbimet si koha minimale e tarifimit, menyra e tarifimit pas kohes minimale, njesia e matjes per tarifimin (p.sh.sekonda,intervale kohore, M/byte etj), ndryshimi i tarifes me kohezgjatjen, koha e kryerjes se thirrjes (peak/off peak) dhe intervalet perkatese kohore te tyre, etj
 - iii Sherbimet shtese te perfshira ne paketen e zgjedhur
 - iv Informacion per cilesine e sherbimeve te ofruara/zgjedhura
- 3.1.27 Te mos refuzoje lidhjen ne rrjet te pajisjeve fundore qe jane ne perputhje me Ligjin 9918 dhe aktet nen-ligjore te tij.
- 3.1.28 Te aplikojë rritjen e tarifes se nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate, vetem pas ezaurimit te procesit te njoftimit te pajtimtarit nga Operatori,

- Nepermjet njoftimit individual (mund te jete edhe me SMS apo telefonate nepermjet Call Center-Sherbimi i klientit) te pakten 30 (tridhjet) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre, ne rastin kur rritja e tarifave aplikohet nga Operatori. Njoftimi individual duhet te perfshije adresen se ku jane publikuar rritjet e tarifave, ne rast se njoftimi nuk permban detaje te mjaftueshme te ndryshimeve;
- Nepermjet mjeteve te informimit publik, jo me pak se 7 (shtate) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre dhe ky njoftim duhet te behet per jo me pak se 3 (tre) dite rrjesht, ne rastin kur rritja e tarifave eshte miratuar nga AKEP me nje vendim te vecante.

3.1.29 Te aplikojte automatikisht edhe pa njoftim uljen e tarifes te nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate, brenda paketes se zgjedhur ne Aneks.

3.1.30 Te mos vendose detyrim financiar per rilidhje ne rrjet nese nderpreja e sherbimit eshte kryer per shkak te gabimeve te Operatorit.

3.1.31 Sipas kerkeses se pajtimtarit, te lejoje mbajtjen e numrit te alokuar ne rast te ndryshimit te operatorit, apo edhe vendndodhjes nese eshte e aplikueshme (portabiliteti i numrit), dhe te lejoje perdorimin nga pajtimtari te sherbimeve te zgjedhjes dhe/ose parazgjedhjes se bartesit te thirrjeve, ne perputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregullator ne fuqi.

3.1.32 Per kufizimet apo per nderprerjet e sherbimit, te cilat zgjasin me shume se 30 min, Operatori ka detyrimin te vere ne dijeni AKEP-in dhe pajtimtaret. Ky njoftim te behet :

- i te pakten 48 ore me pare, ne rast te nje permiresimi, modernizimi ose mirembajtje te rrjetit.
- ii sa me shpejt te jete e mundur, por jo me vone se 48 ore, pas ndodhjes se kufizimit apo nderprerjes se shkaktuar nga defekte apo demtime te rrjetit.

3.2 PAJTIMTARI DETYROHET:

3.2.1 Të kryejë pagesën për shërbimet e ofruara sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara në pikën 6.1.

3.2.2 Të marrë dhe të ruajë kopjen e dokumentave, që vërtetojnë kryerjen e veprimeve financiare për pagesën e faturës.

3.2.3. Të përdore linjën në përputhje me kategorinë e pajtimit të përcaktuar në Kontratë.

3.2.4. Të mos përdorë numrin e tij për t'ju ofruar të tjerëve shërbime telekomunikacioni për qëllime fitimi (rishitje impulsesh).

3.2.5. Të mos lejojë dhe të mos përdorë numrin e tij për të shqetësuar, fyer dhe kërcënuar Pajtimtaret e tjere të rrjeteve te telekomunikacioneve.

3.2.6. Të mos dëmtojë instalimet apo pajisjet telefonike të Operatorit, të cilat ndodhen në territorin dhe objektet pronë private ose publike.

- 3.2.7. Të lejojë ne rast nevojë, për realizimin e ofrimit të shërbimit të pajtimtarit, hyrjen në pronat private, të punonjësve të autorizuar të Operatorit, për të përdorur tokën, trojet dhe objektet e Pajtimtarit në përputhje me nenin 93 të Ligjit nr. 9918.
- 3.2.8 Të likujdojë të gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit deri në momentin e prishjes së kësaj Kontrate.

Neni 4. TË DREJTAT

4.1. OPERATORI KA TË DREJTË:

- 4.1.1 T'i ndërpresë, ofrimin e shërbimeve publike të telekomunikacionit Pajtimtarit, i cili nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga pika 3.2.1, 3.2.3, 3.2.4, 3.2.5.
- 4.1.2 Të caktojë numrat telefonikë të Pajtimtareve brenda hapsirës numerike vënë në dispozicion të tij.
- 4.1.3 Të ndryshojë formatin e numerave dhe numerat e Pajtimtareve për nevoja teknologjike apo detyrime ligjore.
- 4.1.4 Të bëjë ndryshime e përmirësime në rrjetin e tij të telekomunikacioneve sipas nevojave të zgjerimit të rrjetit dhe të teknologjisë.
- 4.1.5 Te beje modifikime të kësaj kontrate për nevoja të pershtatjeve me teknologjitë e reja.

4.2. PAJTIMTARI KA TË DREJTE:

- 4.2.1 Të zgjedhë llojin e linjës në rrjetin e Operatorit.
- 4.2.2. Të përcaktojë shërbimet fillestare dhe shërbimet shtesë që do të përdorë sipas Aneksit të kontratës.
- 4.2.3 Të kërkojë me shkrim prishje të kontratës në mënyrë të njëanshme.
- 4.2.4 Të kërkojë rilidhjen e Kontrates së Pajtimtarit, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të prapambetura.
- 4.2.5 Të kundërshtojë me shkrim vendimet apo veprimet që bien ndesh me ofrimin e shërbimeve sipas kushteve të kësaj kontrate, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit.
- 4.2.6 Te ndryshojë në çdo kohë shërbimet e zgjedhura në aneksin e kësaj kontrate nëpërmjet një kërkesë/njoftimi me shkrim.
- 4.2.7 Të informohet nga Operatori për të gjitha modifikimet e propozuara në kushtet e kontratës së pajtimtarit, brenda një periudhe kohore jo më vonë se 30 ditë përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të këtyre modifikimeve, sipas përcaktimeve në nenin 10.
- 4.2.8 Te anullojë kontratën në rast se nuk është dakord me modifikimin e kushteve të saj (përfshirë rritjen e tarifave), duke njoftuar Operatorin me shkrim ose pranë zyrave të tij, para afatit të hyrjes në fuqi të tyre. Zgjidhja e kontrates nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër.

- 4.2.9 Pajtimtari, pavaresisht percaktimeve ne kete kontrate, zoteron te gjitha te drejttat qe i jep legjislacioni dhe kuadri nen-ligjor shqiptar ne fuqi, veçanerisht Ligji nr. 9918, Ligji nr. 9902, Ligji nr. 9887, përfshirë te drejttat ne lidhje me portabilitetin e numrit, dhe zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartesit te thirrjeve.

Neni 5. FATURIMI

- 5.1. Detyrimet per sherbimet e ofruara, i faturohen Pajtimtarit çdo muaj kalenderik, sipas zgjedhjes te konsumatorit se alternativave perkatese ne Aneks, seksioni C.
- 5.2. Fatura, sipas llojit te zgjedhur nga pajtimtari, emetohet dhe i dorëzohet pajtimtarit në vendin e banimit, ose ne adresen e specifikuar ne Aneks, seksioni C.2, në mënyrë zyrtare (me postë ose dorazi) dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë kalendarike përpara afatit të pagesës së saj.
- 5.3. Ne faturen e derguar pajtimtarit, pervec vlerave te detyrimeve, Operatori perfshin:
- Afatin e pageses se fatures;
 - Menyren dhe vendin e pageses se fatures;
 - Pagesen per cdo komunikim te kryer(sipas zgjedhjes)
 - Sanksionet ne rast moshlyerje te detyrimeve (kamat-vonesat, nderpreje, kufizim te sherbimeve etj)
 - Numer kontakti te Operatorit per Kujdesin ndaj Klientit per informacion per faturen (thirrjet drejt ketij numri jane pa pageese ose me kosto jo me te larte se nje thirrje lokale)

Neni 6. KRYERJA E PAGESAVE

- 6.1. Detyrimet financiare të Pajtimtarit ndaj Operatorit kryhen si më poshtë :
- a-** Për instalimin e numrit, me para në dorë pranë arkës së Operatorit në momentin e firmosjes së kësaj Kontrate.
- b-** Për vlerën e faturës, në një nga mënyrat e mëposhtme :
- me para në dorë pranë njësisë përkatëse arkëtimore të Operatorit
 - me urdhër xhirimi bankar në emër dhe favor të Operatorit, ose në njërën prej Bankave të nivelit të II-të pranë të cilave Operatori ka llogaritë e tij likujduese.
- Detyrimet sipas pikës b), duhet të shlyhen brënda afatit te percaktuar ne fature.
- 6.2 Datë pageese do të konsiderohet :
- a. data e shënuar në mandat arkëtimin, në rastin kur pagesa kryhet me para në dorë pranë njësisë arkëtimore të Operatorit;
 - b. data e prekjes së llogarisë bankare likujduse të Operatorit, në rastin kur pagesa kryhet me urdhër-xhirimi bankar.

Neni 7. SANKSIONET

7.1 Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë dhe/ose Operatori vonon riparimin e difekteve në rrjetin e tij të telekomunikacioneve, tej afateve të percaktuara në pikat 3.1.1 dhe 3.1.5 të kësaj Kontrate, atëherë ai detyrohet t'i zbrese fatures së muajit në vijim 3% së tarifës së pajtimit mujor (me TVSH), për çdo ditë mungese cilësie/vonese riparimi difekti, por jo më shumë se vlera e tarifës së pajtimit mujor (me TVSH).

7.2 Në rast se pajtimtari nuk kryen pagesën e fatures sipas afatit të saj, Operatori ka të drejtë të ndermarre masa kufizuese të ofrimit të shërbimit për pajtimtarin:

- a. Operatori, brenda 15 ditëve pas afatit të pagesës, do të njoftojë pajtimtarin me shkrim ose me SMS/telefonatë nëpërmjet Call Center (kujdesi për klientin) për plotësimin e detyrimit të pagesës apo detyrimeve të tjera kontratore, brenda një afati të arsyeshëm të percaktuar nga Operatori si dhe duke e paralajmëruar pajtimtarin për masat kufizuese që mund të ndermarre Operatori.
- b. Në rast se pajtimtari nuk kryen pagesën apo nuk përmbush detyrimet kontratore brenda afatit të percaktuar, Operatori ka të drejtë të kufizojë, ndërprejë perkohësisht apo perfundimisht ofrimin e shërbimeve. Në këtë rast, Operatori do të dërgojë një njoftim për paralajmërimin e fundit dhe/ose fillimin e masave kufizuese/nderprerjes të perkohëshme apo perfundimtare. Masat kufizuese që mund të ndermarre Operatori janë:
 - i. Pëzullimi i ofrimit të shërbimeve të kontratës, duke i dhënë mundësinë pajtimtarit të thirrjet nga të tjerët (i njëanshëm, vetëm hyrës) dhe të përdorë Shërbimet e Urgjencës;
 - ii. Në rast se pajtimtari nuk ka paguar detyrimin 30 ditë pas afatit të pagesës së fatures, Operatori, pas dërgimit të një Njoftimi dhe paralajmërimi për masën, ka të drejtë të ndërprejë pajtimtarit të gjitha shërbimet e ofruara (thirrjet dalese dhe hyrëse), por duke i lejuar thirrjen drejt numrave të emergjencës.
 - iii. Në rast se pajtimtari nuk ka paguar detyrimin 60 ditë pas afatit të pagesës së fatures, Operatori ka të drejtë të ndërprejë kontratën në mënyrë të njëanshme, duke i dërguar njoftim me shkrim pajtimtarit. Pas kësaj date me shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj Operatorit, Pajtimtari ka të drejtë të rilidhë Kontratën e pajtimit me të njëjtin numer ose me numer të radhës. Operatori ka detyrimin të mos japë numrin e Pajtimtarit, një pajtimtari tjetër, të pakten 6 muaj nga ndërprerja apo perfundimi i kontratës.

7.3 Operatori nuk është i detyruar të njoftojë paraprakisht pajtimtarin për masat e marra në rast se shkelja e evidentuar e kontratës:

- i.** përben një kërcënim serioz të rendit e sigurisë publike, shëndetit e mjedisit;
- ii.** shkakton një dëmtim serioz fizik, material ose funksional të rrjetit

7.4 Nëse është teknikisht e mundur, Operatori është i detyruar të kufizojë aksesin vetëm për ato shërbime që pajtimtari ka shkëlqur kushtet e kontratës, përveç rasteve kur pajtimtari abuzon, ose në mënyrë të perseritur kryen me vonë ose nuk paguan faturat.

7.5 Në rast kur pajtimtari vonon pagesën e vlerës së faturës, tej afatëve të përcaktuara në faturë, dhe brenda kësaj afati nuk ka bërë ankese me shkrim për faturën, Pajtimtari detyrohet t'i paguajë Operatorit kamatë në masën 0.5% të faturës mujore të papaguar, për çdo ditë vonë në pagim nga afati i pagesës së përcaktuar në faturë.

7.6 Në rast se pajtimtari, ka bërë ankese me shkrim për faturën, para afatit të pagesës, atëherë:

- a) Operatori ka detyrimin të trajtojë ankesën dhe kthejë përgjigje sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.
- b) Operatori mund të mos aplikojë masat kufizuese të referuara më sipër.

Neni 8. PRISHJA E NJEANSHME E KONTRATËS

8.1. Operatori mund të prishë Kontratën në mënyrë të njëanshme kur Pajtimtari:

- a. nuk respekton detyrimet e përcaktuara në pikat 3.2.3, 3.2.4. dhe 3.2.5. të kësaj Kontrate;
- b. nuk shlyen pagesat e faturës brenda 60-62 ditëve kalendarike, llogaritur nga data e fundit e muajit të faturuar.

8.2. Pajtimtari ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme dhe pa kosto shtesë, në rastet e modifikimit/zevendësimit të kontratës, nëse nuk është dakort me kushtet e reja përfshirë:

- rritje të tarifës së një apo më shumë shërbimeve;
- përkeqësim të treguesve të cilësive të shërbimit nga Operatori

Zgjidhja e kontratës nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër. Në këto raste pajtimtari duhet të njoftojë Operatorin sipas përcaktimeve të nenit 10.

Neni 9. KUSHTE TË PËRGJITHSHME/AFATET E KONTRATËS

9.1. Palët janë të detyruar të respektojnë dhe zbatojnë dispozitat e Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë “, dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

9.2. Mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet palëve zgjidhen sipas përcaktimeve në Udhezuesin e Mosmarrëveshjeve me pajtimtarin të dhënë si aneks i kësaj kontrate. Në rast se palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, secila mund të drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit ku është lidhur Kontrata.

9.3. Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

- 9.4. Kjo kontrate lidhet per nje afat te percaktuar prej 12 (dymbedhjete) muajsh duke filluar nga data e nenshkrimit te kontrates prej pajtimtarit.
- 9.5. Nese pajtimtari nuk ka njoftuar Operatorin me shkrim ose ne zyrat e tij, se nuk deshiron vazhdimin e kontrates pertej afatit 12 (dymbedhjete) mujor, kontrata kthehet ne kontrate me afat te pacaktuar.
- 9.6. Pas kalimit te afatit fillestar prej 12 muajsh, pajtimtari mund ta zgjidhe kontraten duke njoftuar me shkrim Operatorin per kete ose me deklarim ne dyqanet e operatorit. Operatori do ta zgjidhe kontraten ne fund te muajit ne vazhdim, por asnjehere me vone se 30 (tridhjet) dite nga marrja e njoftimit nga ana e Operatorit. Ne rast se kontrata zgjidhet gjate muajit, tarifa mujore e pajtimit do te paguhet deri ne fund te muajit kalendarik gjate te cilit eshte zgjidhur kontrata.
- 9.7 Ne cdo rast zgjidhjeje te kesaj Kontrate duhet te shlyhen te gjitha detyrimet e Pajtimtarit kundrejt Operatorit.
- 9.8 Ne rast zgjidhjeje te Kontrates per shkak te mosshlyerjes se detyrimeve nga ana e Pajtimtarit, ai qofte personalisht, qofte si person juridik do te humbase te drejten te lidhe nje kontrate tjeter me Operatorin pa shlyer me pare detyrimet e tij te prapambetura ndaj Operatorit. Operatori do te ruaje te drejten e tij per te kerkuar sipas ligjit pagimin e detyrimeve te pashlyera.
- 9.9 Secila pale ka te drejte te kerkoje prishjen e njeanshme te kontrates, sipas percaktimeve te dhena ne kete kontrate.

Neni 10. MODIFIKIMI

- 10.1. Percaktimet e kesaj Kontrate, permbajtja e seksioneve A, B dhe C te Aneksit dhe Udhezuesi per Zgjidhjen e Mosmarreshjeve perbejne Termat e Pergjithshme te Kontrates se lidhur midis Operatorit dhe Pajtimtarit, dhe jane miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr. __, date __.
- 10.2. Termat e Pergjithshme te Kontrates mund te modifikohen apo zevendesohen vetem pas miratimit te ndryshimeve nga AKEP.
- 10.3. Per cdo modifikim/zevendesim te kushteve te pergjithshme, reduktimi te sherbimeve/cilesise dhe rritje te tarifave te sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari, Operatori duhet:
 - Te njoftoje Pajtimtarin nepermjet njoftimit individual (mund te jete edhe me SMS apo me telefon nepermjet Call Center-Sherbimi i klientit) te pakten 30 (tridhjet) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre. Njoftimi individual duhet te perfshije adresen se ku jane publikuar ndryshimet/termat e reja, ne rast se njoftimi nuk permban detaje te mjaftueshme te ndryshimeve;
 - Te njoftoje pajtimtaret nepermjet mjeteve te informimit publik, jo me pak se 7 (shtate) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre dhe ky njoftim duhet te behet per jo me pak se 3 (tre) dite rrjesht, ne rastin kur rritja e tarifave eshte miratuar nga AKEP me nje vendim te vecante.

- 10.4 Permiroshimi i shërbimeve për pajtimtarin si ulja e tarifave dhe rritja e cilësive/shërbimeve mund të aplikohen nga Operatori pa qene nevoja e njoftimit.
- 10.5 Ndryshimet e cituara në pikën 10.3, hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar nga AKEP (në rast se ato janë objekt miratimi nga AKEP) ose nga Operatori.
- 10.6 Në rast se pajtimtari nuk njofton me shkrim Operatorin, sipas pikës 10.7, pajtimtari konsiderohet se i pranon në heshtje ndryshimet dhe efektet e ndryshimeve zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të tyre pa qene i detyrueshëm nënshkrimi i tyre (të një amendamenti apo kontratës së re) nga të dy palët . Palët kanë të drejtë të nënkruajnë amendamentet apo kontratën e re, në çdo kohë para apo pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve.
- 10.7 Në rast se pajtimtari nuk është dakord me modifikimin e kushteve të kontratës (përfshirë rritjen e tarifave) të cituar në pikën 10.3, pajtimtari ka të drejtë të mos pranojë modifikimin/zëvendësimin e kontratës dhe ta anulojë kontratën duke njoftuar Operatorin me shkrim ose në zyrtarë të tij, para afatit të hyrjes në fuqi të tyre. Zgjidhja e kontratës nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër.

Kjo kontratë dhe gjithë elementet e saj hartohet në 2 (dy) kopje të njëvlefshme në gjuhën shqipe, nga të cilat 1 (një) kopje e mban Operatori dhe 1 (një) kopje i dorëzohet Pajtimtarit. Të dy kopjet nënshkruhen nga të dy palët.

Më anë të këtij nënshkrimi vërtetoj se i kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet dhe termat e kësaj kontrate.

Për dhe në emër të Operatorit

firma-vula

.....
.....

(emri-mbiemri i përfaqësuesit të autorizuar)

Pajtimtari

firma

(emri-mbiemri)

ANEKSI NR. 1

Numri I kontrates Pajtimimit

Numri i Telefonit

Lloji I lidhjes ANALOG

DIGITAL

A. Publikimi ne Numratorin telefonik i te dhenave te Pajtimtarit (emri, mbiemri, numri, adresa) :

PO

JO

B. Kufizime te komunikimeve automatike:

Kufizime te komunikimeve me op. MOBILE

Kufizime te komunikimeve me op. me VLERE TE SHTUAR

Kufizime te komunikimeve me op. NDREKOMBETARE

Kufizime të komunikimeve te zgjedhura me siper nëpërmjet Kodit

C. Fatura e sherbimit:

C.1 Fatura e sherbimeve per tu derguar pajtimtarit:

faturë e përmbledhur

faturë e detajuar, me opsionet:

te perfshije te gjithë numrat e thirrur

te perfshije te gjithë numrat e thirrur pervec numrave:

Lokale

- Te emergjences
- Pa pagese (0800) etj

C.2. Adresa e dergimit te fatures dhe njoftimeve me shkrim: _____
adrese e-maili _____

D. Tabela e sherbimeve dhe tarifave

Ne kete seksion pasqyrohen sherbimet baze dhe shtese (pajtimi mujor, instalimi, thirrjet telefonike etj) te ofruara nga Operatori dhe te zgjedhura nga pajtimtari, tarifat perkatese te sherbimeve (pershire sherbimet pa pagese) dhe menyra e tarifimit.

ANEKSI NR. 2

UDHEZUES PER ZGJIDHJEN E ANKESAVE

- 1- Ankesat mund te paraqiten :
 - a- Nepermjet numritte shkurtuar _____ per “Difekte teknke”
 - b- Nepermjet numrit te shkurtuar _____ per “Asistence teknike”
 - c- Nepermjet sporteleve Operatorku merret deklarim shkresor per ankesen.
 - d- Nepermjet postes per ankesa te ndryshme.
 - e- Me email ne adresen : _____
 - f- Me fax ne numrin: _____

- 2- Afati i paraqitjes se ankesave eshte:
 - a- Ankesat per “Difekte Teknike” dhe “Asistence teknike per sherbimin” paraqiten ne cdo kohe (sherbimi 24 oresh);
 - b- Ankesat per vendimet apo veprimet e Operatorit per aksesin apo veprimit te kryer nga Operatori.
 - c- Ankesat per faturim paraqiten deri ne fund te muajit te dyte pasardhes te fatures se ankimuar.
 - d- Ankesa per mos riparim te difekteve te paraqiten menjehere pasi mbaron afati sipas pikave perkatese te kontrates.
 - e- Ankesat e tjera, te cdo lloji qofshin paraqiten sa me pare.

- 3- Ankesat , ne varesi nga natyra e tyre, shqyrtohen nga strukturat perkatese e Operatorit, mbeshtetur ne te dhenat e marra nga Deget apo Sektoret e tjere dhe konform rregullave behet analiza dhe zgjidhja e tyre, konform afateve te parashikuara ne Kontraten e Pajtimimit.

- 4-Afati i nformimit me shkrim te Pajtimtarit mbi rezultatin e shqyrtimit te ankesave sipas pikave 2.b, 2.c,2.d, dhe 2.e eshte brenda 15 diteve nga marrja e tyre.

- 5.Operatori mban nje rregjister te vecante per ankesat e paraqitura sipas pikave 2.b, 2.c, 2.d dhe 2.e., dhe pergjigjet e dhena me shkrim sipas pikes 4, duke i dhene seciles nje numer refernce.

6- Pajtimtaret kane te drejte qe, ne perputhje me percaktimet ne kontrate per zgjidhjen e mosmarreshjeve, te ankohen ne gjykate per vendimin e marre nga Operatori.

**TERMAT E PERGJITHSHSME TE KONTRATES (KONTRATA TIP) TE TEEB
CENTER SH.P.K ME PAJTIMITARIN PER SHERBIMIN E AKSESIT NE INTERNET**

Rajoni/Zona _____

KONTRATE PER SHERBIMIN AKSES NE INTERNET

“.....”

NR. _____

DATE. _____

Emri i Operatorit: _____, Rajoni/Zona _____ Operator i Sherbimit te
Telefonise Publike Fikse qe me poshte do te quhet OPERATOR, me seli ne adresën:
_____ I perfaqesuar nga Z/Znj _____

Dhe

_____, me

adresë....., perfaqesuar nga Z/Znj,

..... me dokument identifikimi Nr

..... që më poshtë do të quhet **PAJTIMITAR.**

BAZA LIGJORE

Kjo Kontrate hartohet në zbatim të :

5. Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
6. Ligjit Nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”;
7. Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
8. Ligje dhe akte nënligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie në Republikën e Shqipërisë.

KUSHTE TË KONTRATËS

Neni 1. OBJEKTI KONTRATËS

Ofrimi i Shërbimit _____ nga Operatori nëpërmjet rrjetit të tij të telekomunikacioneve me specifikimet e dhena në aneks.

Neni 2 Tarifat

1. Shërbimi, parametrat kryesorë të cilësisë dhe tarifa, të ofruara nga Operatori dhe të pranuar nga Pajtimtari, paraqiten në Aneksin e kësaj Kontrate dhe janë pjesë integrale e Kontratës së nënshkruar midis palëve.
2. Tarifat e Shërbimeve janë objekt ndryshimi, të cilat vendosen dhe publikohen sipas kërkesave të ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 DETYRIMET

3.1 OPERATORI DETYROHET :

- 3.1.1 Të mundësojë ofrimin e Shërbimit _____ për Pajtimtarin të pandërprerë 24 në 24 orë e me cilësi, si dhe të sigurojë shpejtësinë e transmetimit të përcaktuar në nenin 1.
- 3.1.2 Të aktivizojë ofrimin e Shërbimit _____ brenda dy diteve pune nga data e nënshkrimit të kontratës.
- 3.1.3 Të evidentojë ankesat dhe shqetësimet e Pajtimtarit dhe ta informojë atë për zgjidhjen e mundshme të tyre brenda 3 (tre) ditëve pune.
- 3.1.4 Të riparojë defektet teknike dhe të rivendosë ofrimin e shërbimit brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, llogaritur nga momenti i njoftimit në numrat e informacionit të Operatorit.
- 3.1.5 Të riaktivizojë shërbimin brenda 24 (njëzetekatër) orëve, nga momenti që Pajtimtari ka shlyer të gjitha detyrimet financiare të prapambetura.
- 3.1.6 Të njoftojë nëpërmjet medias dhe afishimeve, pranë njësisë ankimore e zyrave të tij, çdo ndryshim të tarifave të Shërbimit _____, jo më vonë se 15 ditë kalendarike, përpara zbatimit të tyre.
- 3.1.7 Pas kërkesës me shkrim, të bëjë ndryshimin e paketës _____ ose shpejtësisë së transmetimit ditën e fundit përpara nxjerrjes së faturës mujore.
- 3.1.8 Pas kërkesës me shkrim për prishje kontrate, të bëjë ndërprerjen e Shërbimit _____ ditën e fundit përpara nxjerrjes së faturës mujore.
- 3.1.9 Operatori nuk mban përgjegjësi për problemet apo defektet që mund të vijnë si pasojë e përdorimit të Internetit në mënyrë të pavarur nga Pajtimtari si psh. hapjes së faqeve të

ndryshme Interneti, shkarkimit të programeve nga Interneti, dëmtimi nga viruset, aplikimi i formave të pagesave online etj.

- 3.1.10 Të njoftojë Pajtimtarin për modifikime të kësaj Kontrate jo më vonë se 30 ditë përpara datës së hyrjes në fuqi të këtyre modifikimeve.
- 3.1.11 Të përgatisë, Kontratën dhe gjithë elementet e saj, në format të printuar, lehtësisht të lexueshëm dhe të kuptueshem.
- 3.1.12 Me kërkesën e Pajtimtarit, bën Kontratën të disponueshme për Pajtimtarin në format të përshtshëm për të plotësuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara shikimi.
- 3.1.13 T'i japë Pajtimtarit një shpjegim të hollësishëm të të gjitha kushteve të përdorimit dhe kontratës para nënshkrimit të kontrates.
- 3.1.14 T'i japë Pajtimtarit informacion të detajuar për programet tarifore që mund të zgjedhë Pajtimtari, duke i dhënë mundësinë e krahasimit midis tyre, përfshirë:
 - i. informacion të plotë dhe të qartë, për paketat tarifore dhe ofertat promovionale apo speciale si zbritjet e tarifave, përdorim i pakufizuar i Internetit, duke specifikuar midis të tjerave çfarë përfshihet në paketë/ofertë dhe çfarë nuk përfshihet në to, afatet kohore të ofertave dhe efektet e tejkalimit të tyre, përfshirë tarifat e aplikuara.
 - ii. Sistemin tarifor të aplikuar për shërbimet si kufizime të përdorimit, mënyra e tarifimit pas tejkalimit të kufizimit, njësia e matjes për tarifimin (p.sh.sekonda,intervale kohore, M/byte etj), ndryshimi i tarifës me kohëzgjatjen, koha e kryerjes së thirrjes (peak/off peak) dhe intervalet përktëse kohore të tyre, etj
 - iii. Shërbimet shtesë të përfshira në paketën e zgjedhur
 - iv. Informacion për cilësinë e shërbimeve të ofruara/zgjedhura përfshirë informacion dhe sqarime për shpejtësinë e Internetit.
- 3.1.15 Të mos refuzojë lidhjen në rrjet të pajisjeve fundore që janë në përputhje me Ligjin nr. 9918 dhe aktet nën-ligjore të tij.
- 3.1.16 Te aplikojë rritjen e tarifës se nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate, vetem pas ezaurimit te procesit te njoftimit te pajtimtarit nga Operatori:
 - Nepermjet njoftimit individual (mund te jete edhe me SMS apo telefonate nepermjet Call Center-Sherbimi i klientit) te pakten 30 (tridhjet) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre, ne rastin kur rritja e tarifave aplikohet nga Operatori. Njoftimi individual duhet te perfshije adresen se ku jane publikuar rritjet e tarifave, ne rast se njoftimi nuk permban detaje te mjaftueshme te ndryshimeve;
 - Nepermjet mjeteve te informimit publik, jo me pak se 7 (shtate) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre dhe ky njoftim duhet te behet per jo me pak se 3 (tre) dite rrjesht, ne rastin kur rritja e tarifave eshte miratuar nga AKEP me nje vendim te vecante.
- 3.1.17 Te aplikojë automatikisht edhe pa njoftim uljen e tarifës te nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate,brenda paketes se zgjedhur ne Aneks.

- 3.1.18 Te mos vendose detyrim financiar per rilidhje ne rrjet nese nderpreja e sherbimit eshte kryer per shkak te gabimeve te Operatorit.
- 3.1.19 Sipas kerkeses se pajtimtarit, ne perputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregullator ne fuqi, te lejoje perdorimin e sherbimit te Internetit te ofruar nga sipermarres te tjere.
- 3.1.20 Per kufizimet apo per nderprerjet e sherbimit, te cilat zgjasin me shume se 30 min, Operatori ka detyrimin te vere ne dijeni AKEP-in dhe pajtimtaret. Ky njoftim behet :
- i. te pakten 48 ore me pare, ne rast te nje permiresimi, modernizimi ose mirembajtje te rrjetit;
 - ii. sa me shpejt te jete e mundur, por jo me vone se 48 ore, pas ndodhjes se kufizimit apo nderprerjes se shkakuar nga defekte apo demtime te rrjetit.
- 3.1.21 Të kryeje njoftimin e pajtimtarit me mjete elektronike (si p.sh. mesazh në PC) jo më pak se 3 (tre) ditë rresht kur arihet niveli 80% i “download”/’upload” të përcaktuar në Aneksin 1 të Kontratës;

3.2 PAJTIMTARI DETYROHET

- 3.2.1 Te siguroje me shpenzimet e tij pajisjet (Modem dhe Spliter) per lidhjen e Sherbimit _____.
- 3.2.2 Te kryeje pagesen per sherbimin e ofruar, sipas menyres dhe afateve te percaktuara ne nenin 6 te Kontrates.
- 3.2.3 Te likujdoje te gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, deri ne momentin e prishjes se kesaj Kontrate.
- 3.2.4 Te mos perdore sherbimin e ofruar per qellime ilegale dhe per te kryer vepra qe bien ne kundërshtim me Legjislacionin Shqiptar.
- 3.2.5 Te mos perdore sherbimin _____ per qellime rishitje.
- 3.2.6 Te mos transferoje sherbimin ne palet e treta.
- 3.2.7 Te lidhe ne rrjet vetem pajisje te certifikuara dhe te sigurohet qe teknologjia e tyre eshte e pershtatshme me ate qe kerkohet ne sherbimin _____ te Operatorit.

Neni 4. TE DREJTAT

4.1 OPERATORI KA TE DREJTE

- 4.1.1 T’i nderprese ofrimin e Sherbimit _____ Pajtimtarit, i cili nuk ka zbatuar detyrimet qe rrjedhin nga pikat 3.2.2 -3.2.7.

- 4.1.2 Te nderprese sherbimin ne menyre te njeanshme, duke njoftuar te pakten 24 ore me perpara, per qellime mirembajtje dhe permiresimin e sherbimit. Kohezgjatja e nderprerjes te jete jo me shume se 48 ore:
- 4.1.3 Te ndryshoje tarifat e ofrimit te Sherbimit _____ gjate vlefshmerise se kesaj kontrate.
- 4.1.4 Te modifikoj elementet e Kontrates, duke njoftuar pajtimtaret jo me pak se 30 dite perpara hyrjes ne fuqi te modifikimeve.
- 4.2 PAJTIMTARI KA TE DREJTE.
- 4.2.1 Te perdore pa kufizim Sherbimin _____ ne perputhje me termat e kesaj kontrate.
- 4.2.2 Te kerkoje me shkrim ndryshime te tipit te paketes, shpejtesise se transmetimit apo te adreses (vendodhjes), per te cilat palet bien dakort.
- 4.2.3 Te kerkoje me shkrim prishje te kontrates ne menyre te njeanshme.
- 4.2.4 Te ndryshoje ne cdo kohe sherbimet e zgjedhura ne aneksin e kesaj kontrate nepermjet nje kerkese/njoftimi me shkrim.
- 4.2.5 Të informohet nga Operatori për të gjitha modifikimet e propozuara në kushtet e kontratës së pajtimtarit, brenda një periudhe kohore jo më vonë se 30 ditë përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të këtyre modifikimeve, sipas percaktimeve ne nenin 10.
- 4.2.6 Te anullojë kontratën në rast se nuk është dakord me modifikimin e kushteve te saj (perfshire rritjen e tarifave), duke njoftuar Operatorin me shkrim ose prane zyrave te tij, para afatit te hyrjes ne fuqi te tyre. Zgjidhja e kontrates nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër.
- 4.2.7 Pajtimtari, pavaresisht peraktimeve ne kete Kontrate, zoteron te gjitha te drejttat qe i jep legjislacioni dhe kuadri nen-ligjor shqiptar ne fuqi, vecanerisht Ligji nr. 9918, Ligji nr. 9902, Ligji nr. 9887.

Neni 5 FATURIMI

5.1 Faturimi per Pajtimtarin mujor do te behet me parapagim.

5.2 Faturimi i pajtimit mujor:

- i. do te perfshihet cdo muaj (si ze me vete) ne faturen e sherbimit telefonik te muajit paraardhes, nese Pajtimtari perfiton nga Operatori sherbimin publik telefonik fiks,ose
- ii. do te kryhet me fature te vecante nese Pajtimtari nuk perfiton nga Operatori sherbimin publik telefonik fiks.

Ne te dy rastet, fatura do te dergohet ne njesine perkatese arketimore te Operatorit dhe i dorëzohet Pajtimtarit në vendin e banimit, në mënyrë zyrtare (me postë ose dorazi) dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë kalendarike përpara afatit të pagesës së saj.

5.3 Faturimi per mbipagesen do te behet ne faturen e muajit pasardhes.

5.4 Ne faturen e derguar Pajtimtarit, pervec vlerave te detyrimeve, Operatori perfshin:

- Afatin e pageses se fatures;
- Menyren dhe vendin e pageses se fatures;
- Pagesat shtese;
- Sanskionet ne rast moshlyerje te detyrimeve (kamat-vonesat, nderpreje, kufizim te sherbimeve etj);
- Numer kontakti te Operatorit per Kujdes ndaj Klientit per informacion per faturen (thirrjet drejt ketij numri jane pa pagese ose me kosto jo me te larte se nje thirrje lokale).

Neni 6. KRYERJA E PAGESAVE

Detyrimet financiare te Pajtimtarit ndaj Operatorit kryhen si me poshte:

- 6.1 Per vleren e instalimit, me LEK ne dore, vetem njehere, prane arkes se Operatorit ose me Urdher-Xhirimi ne emer dhe ne favor te Operatorit, sipas percaktimeve ne faturen e leshuar, ne momentin e firmosjes se kesaj Kontrate, referuar tarifave te percaktuara ne Aneks-Kontrate.
- 6.2 Per vleren e pajtimit mujor menjehere me ofrimin e sherbimit:
- a) me faturen mujore te sherbimit telefonik, sipas nenit 6.1.b te “Kontrates se Pajtimit” ne rrjetin telefonik publik te Operatorit, në rast se Pajtimtari Perfiton nga Operatori sherbimin publik telefonik fiks,ose
 - b) Sipas afateve te fatures se vecante nese Pajtimtari nuk perfiton nga operatori sherbimin publik telefonik fiks;
 - c) per muajin e pare, me lek ne dore prane arkes se Operatorit, ne momentin e firmosjes se kesaj Kontrate, sipas diteve kalendarike, duke fillur 2 dite pas dates se nenshkrimit te saj deri ne ditën e fundit perpara nxjerjes se fatures mujore te sherbimit telefonik.
- 6.3 Detyrimet sipas pikes 6.2 duhet te shlyhen brenda 30 (tridhjete) diteve kalendarike te llogaritura nga dita e fundit e muajit te faturuar.
- 6.4 Date pagese do te konsiderohet:
- a) Data e shenuar ne mandat arketimi, ne rastin kur pagesa kryhet me LEK ne dore prane njesise arketimore te Operatorit.
 - b) Data e prekjes se llogarise bankare likujduese te Operatorit, ne rastin kur pagesa kryhet me Urdher-Xhirimi bankar.

Neni 7 SANKSIONET

- 7.1 Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë dhe/ose Operatori vonon riparimin e difekteve ne rrjetin e tij te telekomunikacioneve, tej

afateve te percaktuara ne pikat 3.1.4 te kesaj Kontrate, atehere ai detyrohet t'i zbrese fatures se muajit ne vijim 3% se tarifes se pajtimit mujor (me TVSH), per cdo dite mungese cilesie/vonese riparimi difekti, por jo me shume se vlera e tarifes se pajtimit mujor (me TVSH).

7.2 Ne rast se Pajtimtari vonon pagesen e vlefes se fatures mujore tej afateve te percaktuara ne piken 6.3 te kesaj Kontrate, atehere:

- a) Deri ne daten 15 te muajit pasardhes, Pajtimtari detyrohet t'i paguaje Operatorit kamate ne masen 0.5 % te vleres se fatures mujore te papaguar per cdo dite vonese.
- b) Ne daten 16 te muajit pasardhes Pajtimtarit i nderpritet ofrimi i sherbimit. Nga data 16 deri ne ditet e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore te muajit pasardhes negociohet per zgjidhjen e mosmarreshjeve, kryerjen e pageses se fatures mujore, kamat vonesat etj.
- c) Nese pas perfundimit te afatit sipas pikes 7.2/b mosmarreshjet nuk zgjidhen atehere ceshtja kalon per zgjidhje ne Gjykatën e Rrethit.
- d) Ditën e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore te muajit pasardhes, Kontrata quhet e nderprere.

7.3 Ne rast se Pajtimtari nuk kryen pagesen e fatures sipas afatit te saj, Operatori ka te drejte te ndermarre masa kufizuese te ofrimi te sherbimit per Pajtimtarin:

- c. Operatori, brenda 15 diteve pas afatit te pageses, do te njoftoje Pajtimtarin me shkrim shkrim ose me SMS/telefonate nepermjet Call Center (kujdesi per klientin) per plotesimin e detyrimit te pageses apo detyrimeve te tjera kontratore, brenda nje afati te arsyeshem, jo me pak se 15 dite, te percaktuar nga Operatori si dhe duke e paralajmeruar Pajtimtarin per masat kufizuese qe mund te ndermarre Operatori.
- d. Ne rast se Pajtimtari nuk kryen pagesen apo nuk permbush detyrimet kontraktore brenda 30 diteve nga afati i pageses se fatures, Operatori ka te drejte te kufizojë apo nderprese perkohesisht ofrimin e sherbimeve. Ne kete rast, Operatori do te dergoje nje njoftim per palajmerimin e fundit dhe/ose fillimin e masave kufizuese/nderprerjes te perkoheshme apo perfundimtare.
- e. Ne rast se Pajtimtari nuk ka paguar detyrimin 60 dite pas afatit te pageses se fatures, Operatori ka te drejte te nderprese kontraten ne menyre te njehshme, duke i derguar njoftim Pajtimtarit 10 dite perpara nderprejes. Pas kesaj date me shlyerjen e te gjitha detyrimeve ndaj Operatorit, Pajtimtari ka te drejte te rilidhe Kontraten e Pajtimit.

7.4 Operatori nuk eshte i detyruar te njoftoje paraparakisht Pajtimtarin per masat e marra ne rast se shkelja e evidentuar e kontrates:

- i. perben nje kercenim serioz te rendit e sigurise publike, shendetit e mjedisit;
- ii. shkakton nje demtim serioz fizik, material ose funksional te rrjetit

7.5 Nese eshte teknikiisht e mundshme, Operatori eshte i detyruar te kufizojë aksesin vetem per ato sherbime qe Pajtimtari ka shkelur kushtet e kontrates, pervec rasteve kur Pajtimtari abuzon, ose ne menyre te perseritur kryen me vonese ose nuk paguan faturat.

~~7.6~~ 7.6 Ne cdo rast kur Pajtimtari vonon pagesen e vleres se fatures, tej afateve te percaktuara ne fature, dhe brenda ketij afati nuk ka bere ankese me shkrim per faturen, Pajtimtari detyrohet t'i paguaje Operatorit kamate ne masen 0.5% te fatures mujore te papaguar, per cdo dite vonese ne pagim nga afati i pageses se percaktuar ne fature.

~~7.7~~ 7.7 Ne rast se Pajtimtari, ka bere ankese me shkrim per faturen, para afatit te pageses, atehere:

c) Operatori ka detyrimin te trajtojë ankesen dhe ktheje pergjigje sipas percaktimeve te kesaj kontrate.

d) Operatori mund te mos aplikojë masat kufizuese te referuara me siper.

Neni 8 PRISHJA E NJEANSHME E KONTRATES

8.1 Operatori mund te prishe kontraten ne menyre te njeanshme kur Pajtimtari nuk shlyhen pagesat e fatures sipas nenit 6 te kesaj Kontrate.

8.2 Pajtimtari ka te drejte ta quaj kete Kontrate te prishur ditën e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore pavarsisht nga data e paraqitjes se kerkeses se tij me shkrim.

8.3 Pajtimtari ka te drejte te zgjidhe Kontraten ne menyre te njeanshme dhe pa kosto shtese, ne rastet e modifikimit/zevendesimit te kontrates, nese nuk eshte dakort me kushtet e reja perfshire:

- rritje te tarifes se nje apo me shume sherbimeve;
- perkeqesim te treguesve te cilesise se sherbimit nga Operatori

Zgjidhja e kontrates nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër. Ne keto raste pajtimtari duhet te nftojë Operatorin sipas peraktimeve te nenit 10.

Neni 9 KUSHTE TE PERGJITHSHME

9.1 Kjo Kontrate hartohet dhe interpretohet nga Palet ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore te Republikës se Shqiperise.

9.2 Mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet palëve zgjidhen sipas percaktimeve ne Udhezuesin e Mosmarrveshjeve me pajtimtarin te dhena si Aneks i kesaj Kontrate. Ne rast se palet nuk arrijne të zgjidhin mosmarrveshjen me mirëkuptim, secila mund ti drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit ku është lidhur Kontrata.

9.3 Kjo Kontrate hyn ne fuqi ne ditën e nenshkrimit te saj nga palet.

9.6. Kjo kontrate lidhet per nje afat te percaktuar prej 12 (dymbedhete) muajsh duke filluar nga data e nenshkrimit te kontrates prej pajtimtarit.

- 9.7. Nëse pajtimtari nuk ka njoftuar Operatorin me shkrim ose në zyrat e tij, se nuk dëshiron vazhdimin e kontratës përtej afatit 12 (dymbëdhjetë) muaj, kontrata kthehet në kontratë me afat të pacaktuar.
- 9.6. Pas kalimit të afatit fillestar prej 12 muajsh, pajtimtari mund ta zgjidhë kontratën duke njoftuar me shkrim Operatorin për këtë ose me deklaramë në dyqanet e operatorit. Operatori do ta zgjidhë kontratën në fund të muajit në vazhdim, por asnjehere më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga ana e Operatorit. Në rast se kontrata zgjidhet gjatë muajit, tarifa më e lartë e pajtimit do të paguhet deri në fund të muajit kalendarik gjatë të cilit është zgjidhur kontrata.
- 9.7 Në çdo rast zgjidhjeje të kësaj Kontrate duhet të shlyhen të gjitha detyrimet e Pajtimtarit kundrejt Operatorit.
- 9.10 Në rast zgjidhjeje të Kontrates për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve nga ana e Pajtimtarit, ai qoftë personalisht, qoftë si person juridik do të humbasë të drejtën të lidhë një kontratë tjetër me Operatorin pa shlyer më parë detyrimet e tij të prapambetura ndaj Operatorit. Operatori do të ruajë të drejtën e tij për të kërkuar sipas ligjit pagimin e detyrimeve të pashlyera.
- 9.11 Secila palë ka të drejtë të kërkojë prishjen e njëanshme të kontratës, sipas përcaktimeve të dhëna në këtë kontratë.

Neni 10. MODIFIKIMI

- 10.4. Përcaktimet e kësaj Kontrate dhe Udhëzuesi për Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve përbejne Termat e Përgjithshme të Kontrates së lidhur midis Operatorit dhe Pajtimtarit, dhe janë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. __, datë __. __. __.
- 10.5. Termat e Përgjithshme të Kontrates mund të modifikohen apo zëvendësohen vetëm pas miratimit të ndryshimeve nga AKEP.
- 10.6. Për çdo modifikim/zëvendësim të kushteve të përgjithshme, reduktimi të shërbimeve/cilësive dhe rritje të tarifave të shërbimeve të zgjedhura nga pajtimtari, Operatori duhet:
- të njoftojë Pajtimtarin nëpërmjet njoftimit individual (mund të jetë edhe me SMS apo me telefon nëpërmjet Call Center-Sherbimi i klientit) të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre. Njoftimi individual duhet të përshijë adresën se ku janë publikuar ndryshimet/termat e reja, në rast se njoftimi nuk përmban detaje të mjaftueshme të ndryshimeve;
 - të njoftojë pajtimtarët nëpërmjet mjeteve të informimit publik, jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre dhe ky njoftim duhet të bëhet për jo më pak se 3 (tre) ditë rrjesht, në rastin kur rritja e tarifave është miratuar nga AKEP me një vendim të vecantë.
- 10.8 Përmirësimi i shërbimeve për pajtimtarin si ulja e tarifave dhe rritja e cilësive/shërbimeve mund të aplikohen nga Operatori pa qenë nevoja e njoftimit.
- 10.9 Ndryshimet e cituara në pikën 10.3, hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar nga AKEP (në rast se ato janë objekt miratimi nga AKEP) ose nga Operatori.

10.10 Ne rast se pajtimtari nuk njofton me shkrim Operatorin, sipas pikes 10.7, pajtimtari konsiderohet se i pranon ne heshtje ndryshimet dhe efektet e ndryshimeve zbatohen nga data e hyrjes ne fuqi te tyre pa qene i detyrueshem nenshkrimi i tyre (te nje amendamenti apo kontrates se re) nga te dy palet . Palet kane te drejte te neshkruajne amendamentet apo kontraten e re, ne cdo kohe para apo pas hyrjes ne fuqi te ndryshimeve.

10.11 Në rast se pajtimtari nuk është dakord me modifikimin e kushteve te kontrates (perfshire rritjen e tarifave) te cituar ne piken 10.3, pajtimtari ka te drejte te mos pranoje modifikimin/zevendesimin e kontrates dhe ta anulojë kontratën duke njoftuar Operatorin me shkrim ose ne zyrat e tij, para afatit te hyrjes ne fuqi te tyre. Zgjidhja e kontrates nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër.

Kjo kontrate dhe gjithe elementet e saj hartohet ne 2 (dy) kopje te njevlefshme ne gjuhen shqipe, nga te cilat 1 (nje) kopje e mban Operatori dhe 1 (nje) kopje i dorezohet Pajtimtarit. Te dy kopjet nenshkruhen nga te dy palet.

Me ane te ketij nenshkrimi vertetoj se i kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet dhe termat e kesaj kontrate.

Neni 10. ADRESA (Kontaktet) :

Rajoni/ Zona

.....

Adresa:

.....

NIPT:

.....

Kodi Fiskal:

.....

PAJTIMTARI:

ANEKSI nr.1 _____

Tabela e sherbimeve dhe tarifave

Ne kete seksion pasqyrohen sherbimet baze dhe shtese te ofruara nga Operatori dhe te zgjedhura nga pajtimtari, tarifat perkatese te sherbimeve, menyra e tarifimit dhe parametrat teknike dhe cilesore te sherbimit.

Shpejtësia e transmetimit: _____

+ _____ e-mail falas. _____

ANEKSI NR. 2

UDHEZUES PER ZGJIDHJEN E ANKESAVE

- 4- Ankesat mund te paraqiten :
- g- Nepermjet numritte shkurtuar _____per “Difekte teknke”
 - h- Nepermjet numrit te shkurtuar _____per “Asistence teknike per sherbimin _____”
 - i- Nepermjet sporteleve te Operatorit ku merret deklarim shkresor per ankesen.
 - j- Nepermjet postes per ankesa te ndryshme.
 - k- Me email ne adresen : _____
 - l- Me fax ne numrin : _____
- 5- Afati i paraqitjes se ankesave eshte:
- f- Ankesat per “Difekte Teknike” dhe “Asistence teknike per sherbimin _____” paraqiten ne cdo kohe (sherbimi 24 oresh);
 - g- Ankesat per vendimet apo veprimet e Operatorit per aksesin apo veprimet te kryer nga Operatori.
 - h- Ankesat per faturim paraqiten deri ne fund te muajit te dyte pasardhes te fatures se ankimuar.
 - i- Ankesa per mos riparim te difekteve te paraqiten menjehere pasi mbaron afati sipas pikave perkatese te kontrates.
 - j- Ankesat e tjera, te cdo lloji qofshin paraqiten sa me pare.
- 6- Ankesat , ne varesi nga natyra e tyre, shqyrtohen nga strukturat perkatese e Operatorit, mbeshtetur ne te dhenat e marra nga Deget apo Sektoret e tjere dhe konform rregullave behet analiza dhe zgjidhja e tyre, konform afateve te parashikuara ne Kontraten e Pajtimimit.
- 4-Afati i nformimit me shkrim te Pajtimtarit mbi rezultatin e shqyrtimit te ankesave sipas pikave 2.b, 2.c,2.d, dhe 2.e eshte brenda 15 diteve nga marrja e tyre.
- 5.Operatori mban nje rregjister te vecante per ankesat e paraqitura sipas pikave 2.b, 2.c, 2.d dhe 2.e., dhe pergjigjet e dhena me shkrim sipas pikes 4, duke i dhene seciles nje numer refernce.
- 6- Pajtimtaret kane te drejte qe, ne perputhje me percaktimet ne kontrate per zgjidhjen e mosmarreveshjeve, te ankohen ne gjykate per vendimin e marre nga Operatori.